# Gazeta e Prindit #3

# Ngjarjet e ardhëshme

*Foleja e Shqiponjave"*

**Nentor-Dhjetor 2018**

2445 23 Ave SW, Calgary, AB T2T 0W3

T: 403-466-4172

Website: https://www.albcanyyc.org/

ehttps://www.nakedwines.com/angelsmail : 12dracana@gmail.com

**KUR: Te Dielen me 20 Janar,19 1:00 – 4:00 pm**

**ĆFARË: Rregjistrimet e femijeve per Semestrin 2**

**KU: Central Library** 800 3 Street SE Calgary, T2G 2E7

## NJOFTIM I RËNDËSISHËM

Fëmijët tanë po rriten në vënd të huaj, por çdo prind dëshëron të mbajë lidhje me atdheun. Për këtë duhet t'i sillni tek "Foleja e Shqiponjave" ku mësohet gjuha dhe kultura shqiptare me metoda dhe teknologji bashkëkohore. Semestri i dytë fillon me datën 3 Shkurt, 2019. Regjistroni fëmijët **para datës 15 Janar** dhe mos paguani cmimin e rregjistrimit ($20) dhe as çmimin e materialeve ($20) = $40

**SA BUKUR KUR FEMIJET MESOHEN SE JANE SHQIPTARE EDHE PSE JETOJNE NE KANADA!**

SHKOLLA FOLEJA E SHQIPONJAVE U PARAQIT ME SHUMË DINJITET NË FESTIMET E FESTËS SË FLAMURIT ME DATËN 24 NËNTOR, 2018. FËMIJËT TANË TË MREKULLUESHËM SOLLËN EMOCIONE TË FORTA NË SALLËN ME 630 PJESMARRËS KUR ME SOLEMNITET SOLLËN FLAMURIN NË SALLE NËN TINGUJT E ZËRIT VIRTUOZ TË KËNGETARIT MENTOR XHEMALI ME KËNGËN « PËR TY ATDHE ».

NXËNËSIT E “FOLESË SË SHQIPONJAVE” PARAQITËN NJË MONTAZH MUZIKO LETRAR ME TEMËN “SHQIPONJAT FLUTUROJNË LART”. SI REZULTAT I PUNËS SË PALODHUR TË ANTAREVE TË BORDIT ZOICA DHAMO, GËZIM UGZMAILI, VJOLLCA GURI DHE TË VULLNETAREVE TONA TË MREKULLUESHME ERMIRA DHE KALTRINA KUSARI, DORENTINA TOFAJ KONCERTI DOLI ME SHUMË SUKSES. FALENDEROJMË PRINDERIT QË N’A MBËSHTETËN FUQIMISHT NË KËTË AKTIVITET KUPTIMPLOTË. NË MËNYRË TË VECANTË NË KËTË KONCERT U DALLUAN NXËNËSIT E GRUPIT TË SHQIPONJAVE POR EDHE GRUPI I YLLKAVE N’A NDEROI ME VJERSHAT E BUKURA TE ARJANES, AGNEZ DHE ÇESKËS SË VOGËL. ME KËTË RAST DUAM TË FALENDEROJMË EDHE PARTNERIN TONË BESTBUY PËR NDIHMËN E VAZHDUESHME QË JEP PËR SHKOLLËN TONË.

FËMIJËT ISHIN TË ENTUZIAZMUAR QË KISHIN NË MES TYRE KRYETARIN E BASHKISË SË CALGARY, NAHEED NENSHI, TË CILIT I MËSUAN SHENJËN E SHQIPONJËS. FËMIJËT MORËN PJESË EDHE NË PRERJEN E KEKUT TË FESTËS NGA AMBASADORI I SHQIPERISE, ERMAL MUCA. KËTO KUJTIME DO TË MBETEN NË MENDJEN E FËMIJËVE PËR VITE TË TËRA DHE DO TË NGJALLIN DASHURINË DHE KRENARINË PËR ATDHEUN E DASHUR - SHQIPERINE.

KËNAQESI E VECANTË PËR FËMIJËT, MËSUESIT DHE PRINDËRIT QË KISHIN MES TYRE AMBASADORIN E SHQIPERISE, ERMAL MUCO, I CILI U DHUROJ LIBRA SHKOLLOR PËR TË MËSUAR GJUHËN SHQIPE.

# Fëmijët tregojnë me krenari punimet e tyre me temën « Jam Shqiptar ».

BORDI I SHKOLLËS RAPORTON PËR ARRITJET E DERITANISHME DHE PLANET PËR TË ARDHMEN.

KOSTUMET KOMBETARE HIJESHUAN SALLEN E MBREMJES SE FESTES SE FLAMURIT.

**JA SI SHUMËFISHOHET RESPEKTI PËR SHQIPERINË** - Shelqere Gjordumi edukatore kopështi, n'a dërgon këtë foto të bukur ku fëmijët Kanadez të kopështit BrightPaths në Calgary po vizatojnë flamurin tonë pasi edukatorja u ka folur për Festën e Flamurit të Shqipërisë. Sa bukur kur Shqipja jonë fluturon edhe në klasat e shkollave në Kanada.

**KENDI I PRINDIT**

## *Autoriteti i Prindit?*

Autoriteti si koncept është çështje e ndërlikuar. Kur ky autoritet i kalon kufijtë, ai bëhet i padurueshëm, nga ana tjetër, kur nuk është i mjaftueshëm, ndjehemi si të braktisur; sikur të tjerët nuk e kanë shumë mendjen tek ne. Shpesh ndeshim prindër që janë të shqetësuar për fëmijët dhe ose thonë : « Eshtë i papërgjegjshën. Duhet t'a kesh nën vëzhgim të pandërprerë », apo prindër që kanë vendosur të lëshojnë pe me tepricë duke u justifikuar : »….epo, nuk n'a dëgjojnë më, kështu që nuk kemi pse e prishim gjakun. »

Përballë ABUZIMIT ME AUTORITETIN ne mbyllemi në vetvehte, tërhiqemi përmes fantazisë apo qoftë edhe fizikisht – pra FSHIHEMI. Edhe kur bëjmë sikur nuk ka ndodhur gjë kur fëmijët krijojnë situata konflikti me prindin, ne jemi të përfshirë në të që ç'ke me të. Dhe është e domosdoshme të pyesim vehten – si arritëm deri në këtë pikë?

Kur flasim për « autoritet prindëror », nuk duhet të kuptojmë një autoritet absolut të prindit ndaj fëmijës, por as një përkedhelje pa vënd dhe nënshtrim pa kushte ndaj tekave të fëmijës. Rritja e fëmijëve tanë në Kanada është një detyrë sa jetike aq edhe e vështirë sepse nga njëra anë duhet të bëjmë kujdes që fëmijët tanë të integrohen në shkollat dhe shoqërinë Kanadeze dhe nga ana tjetër duam që fëmijë tanë të ruajnë gjuhën dhe traditat e bukura Shqiptare. Detyrë jo shumë e lehtë për prindin, në mënyrë të vecantë në këto kohë kur media sociale dhe mjetet elektronike e kanë zënë për fyti globin tonë.

Megjithëatë, detyrat tona si prindër nuk janë të pa-arritëshme nëqoftëse ne: a) vendosim me fëmijët një model të mbështetur në një sistem « meritokracie » me dy komponente : përgjegjësi dhe privilegje; b) mbajmë linja komunikimi të hapura me fëmijet.

a) **Sistemi i meritokracisë** – do të thotë që fëmija të kryej detyrat (rezultate të larta në shkollë, dhomë e pastër, sjellje shembullore, etj) përpara se të kërkojë privilegje (celular, internet, veshje te shtrenjta etj).

**NUK KRYHEN DETYRAT = NUK KA PRIVILEGJE.**

b) **Komunikim i hapur** – do të thotë që prindi të mos japë urdhëra, por të ulet me fëmijën dhe të arsyetojë cilat janë detyrat dhe si do të kryhen ato (expectations). **Këto detyra do të kryhen,** por se si do të aplikohen këto vendime?

LE T'I KËRKOJË FËMIJËS MENDIMIN DUKE E BËRË ATË PËRGJEGJËS PËR ZBATIMIN E KËTIJ PLANI TË PËRBASHKËT.

Provojeni këtë strategji dhe do të shikoni rezultate shumë të këndëshme në familjen tuaj.

**Të nderuar Prindër, kërkojmë mendimet tuaja për planet që propozojmë.**

**Ju lutemi n'a ndihmoni me mendimet tuaja.**

**Këto çështje do të diskutohen në Mbledhjen e Përgjithëshme të Prindërve me**

**27 Janar, 2019 @ 1 :30 pm**

Planet afatshkurtëra:

| Çështja | Problemi | Zgjidhja e Propozuar |
|---|---|---|
| 1- rregjistrimi për semestrin 2 | Shpresojmë që femijet që kemi të qëndrojnë për semestrin 2, por duhet të informojmë edhe familjet e tjera që kanë fëmijë të moshës shkollore. Si do të ndihmojmë miqtë e shokët që të sjellin fëmijët tek Foleja? | Të vendosim afatin e rregistrimit për semestrin 2<br>Të gjejmë dhe krijojmë listën e fëmijëve në Calgary dhe kontaktet? Shkolla dhe prindërit do të merret me këtë detyrë |
| 2-ndarja e klasave semestrin 2 | Disa fëmijë kanë ardhë tek Foleja për 3 vjet dhe kanë marrë pothuajse të njëjtat mësime – kjo është "boring" dhe pa fryt. Si t'i ndajmë klasat për semestrin 2 në përputhje me nivelin e Gjuhes Shqipe të fëmijës? | Sa nxënës për klasë?<br>Të krijojmë 3 nivelet – Fillestar, i Mesëm dhe i Përparuar<br>Të përdorim Abetaren për Fillestarët, Gjuha Shqipe 2 për Mesëm dhe Gjuha Shqipe 3 per të Përparuarit. |

| | | |
|---|---|---|
| 3-Shpërndarja e librave | Kemi vetem 14 libra dhe këto libra duhet të përdoren nga brezat e ardhshëm. Si do të mirëmbahen dhe ruhen këto libra që të kthehen në gjëndje të mirë në Qershor? | Si t'i shperndajmë dhe grumbullojmë librat në fund të vitit shkollor?<br>Çfarë mund të bëjnë prindërit që të n'a ndihmojnë në mirëmbajtjen e tyre? |
| 4-Përfshirja e prindërve | Prindërit kanë treguar gatishmëri por deri tani nuk e kemi shfrytëzuar sa duhet këtë gatishmëri në mësimdhënje. | Çfarë temash duhet të ftohen prindërit<br>Trajnimi i prindërve në përdorimin e programeve dixhitale (quizlet, tarsia, youtube) që të punojnë me fëmijët në shtepi. |
| 5- Detyra shtëpije | Vetëm 2 orë mësim në javë janë të pamjaftueshme, duhen dhënë detyra shtëpije të bëhen në shtëpi me me ndihmën e prindit. | Si ju duket kjo ide?<br>Kush do t'a bëjë këtë detyrë? |
| 6- Konkurse me fëmijët | Aktivitetet artistike janë të pakta. | Çfarë aktivitetesh mund të bëjmë?<br>Ku? Kur? Kush? |
| 7-Ditëlindjet e fëmijëve | Mungon lidhja e duhur shoqërore ndërmjet fëmijëve që të krijohet një ambjent i ngrohtë tek Foleja. | Çfarë të bëjmë – një kek për ditëlindjet e fëmijëve në fund të çdo muaji? |
| 8-Përdorimi i teknologjisë/ BestBuy | Deri tani nuk e kemi përdorur teknologjinë në mënyrë të mjaftueshme. BestBuy është i gatshëm por nuk e kemi shfrytëzuar sa duhet. | Çfarë? Kush? Si? |

## Planet afatgjata:

| **Ceshtja** | **Problemi** | **Zgjidhja e propozuar** |
|---|---|---|
| 1- Akreditimi i Folesë | Pa akreditim ne mbetemi një mikro-shkollë | Kur? Si? Kush? |
| 2- 3 kredite për shkollën e mesme | Fëmijët e shkollave të mesme nuk janë përfshirë fare. | Aprovimi i Gjuhës Shqipe si gjuhë e huaj nga Alberta Learning Kush? Si? |
| 3- Grupi i valleve | Argëtimi i fëmijëve nuk është në nivelin e duhur. | Kur? Kush? Si? |
| 4- Seminare si të edukojmë fëmijët | Shumë prindër kanë pyetje si të punojnë me edukimin e fëmijëve të tyre sipas standarteve Kanadeze. | Kemi psikologë shqiptarë me Ph.D. në këtë fushë. Le t'i ftojmë për të diskutuar tema të ndryshme për edukimin e fëmijëve. |
| 5- Seminare për shkollat e mesme- si aplikohet për universitet, si fitohen bursat, etj. | Duhen integruar nxënësit e shkollave të mesme. | Kush? Kur? |
| 6- Seminare për rregjistrimet në shkollën e mesme, kërkesat për të | Fëmijët kalojnë trauma kur kalojnë nga klasa 9 në shkollë të mesme dhe | Kur? Kush? |

| | | |
|---|---|---|
| marrë diplomë apo çertificatë të shkollës së mesme | prindërit nuk dinë se si të lidhen me shkollën, zgjedhin klasat, graduation, counselors. | |
| 7- Mësim Anglishtje për bashkëatdhetarët | Shumë nga bashkëatdhetarët nuk flasin Anglisht dhe kjo nuk i ndihmon në itegrimin në shoqerinë Kanadeze. Për t'u bërë qytetar Kanadez duhet dhënë provimi IELTS ose CELPIP. | Si? Kush? Kur? |
| 8- Përgatitje për citizenship test | Bashkëatdhetarët përgatiten për citizenship, ligjet kanë ndryshuar dhe janë më të rrepta për të marrë pasaportën . | Si t'i ndihmojme? |
| 9- Ngritja e fondeve për shkollën | Duhen më shumë fonde për femijet. | Si? Kush? |

*Mësueset e nderuara të Folesë falenderohen nga komuniteti !*

**JU PRESIM TEK FOLEJA!**